



256/4
24.08.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	24.08.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 256/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren <i>[Signature]</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.74/2017 të dt. 07.08.2017 për lëndën Shenoll Krasniqi dhe Lulzim Elezi Nr.04-353-89114 për ndërtimin e objektit shtëpi individuale për banim me lokal afarist, në ngastrën kadastrale Nr.2227-0 Z.K. Prizren.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA
439 21.08.2017
PODSTUP

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 74/2017
Datë: 07.08.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: "Miratimi, i projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim në ngastrën kadastrale 2227 – 0 Z. K. Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit dhe arsytimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues i cili duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e zyrtarëve profesional nga Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Shenoll Krasniqi dhe Lulzim Elëzinga Prizreni kanë parashtruar kërkesën për ndërtimin e shtëpisë individuale për banim, në ngastrën kadastrale me Nr. 2227 – 0. Etazhiteti i objektit ekzistues është P+0, ndërsa etazhiteti i ndërtesës së re do të jetë B+P+2. Sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, parcela ku kërkohet të ndërtohet gjendet në zonën e VI – të (Zona e shfrytëzimit të përzier dhe banimit). Bazuar në këtë plan, etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9.5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet 60% e sipërfaqes së parcelës. Në afërsi të parcelës ku do të ndërtohet objekti gjenden objektet si Xhamia e Haxhi Ramadanit, Shtëpia e familjes Bilurdaku – Grazgdo, Shtëpia e familjes Kadriaj (Mijic), Kulla e Sahatit – Muzeu Arkeologjik, të cilat kanë status të mbrojtur dhe gjenden në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme” (10.10.2016 – 10.10.2017). Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit aprovon projektin ideor.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë

1. Aprovohet projekti ideor për ndërtim të objektit – shtëpi individuale e banimit në parcelën kadastrale me nr.2227-0, me pronarë Shenoll Krasniqi dhe Lulzim Elezi.
2. Ndërtimi bëhet edhe nën mbikëqyrjen e IKMM-së, përmes QRTK Prizren.
3. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK – Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në).

Mbi bazën e këtij arsyetimi (rekomandimi të Komisionit) është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi. Kushtet e vendosura në arsyetim konsiderohen në tërësi, obligative.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

